

ANKESË

Për: Organin Shqyrtues të Prokurimit

Kunder: Komunes së Gracanices

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	GRA618-25-5794-2-1-1
Nr i brendshëm	GRA618-25-013-211

Titulli: **Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Vellezerit Fazliu pn

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

044 611 111

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Bastri Ademi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

autoserviseuropa@hotmail.com

(Adresa elektronike)



14.07.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë më 27.06.2025
Kërkes për Rishqyrtim me 07.07.2025
Refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim me 08.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qellimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 28 i LPP-se

Neni 40 Njoftimi i Kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I është e interesuar që të marrë pjesë tenderin e organizuar nga **Komuna e Graçanices** me numer të prokurimit : **GRA618-25-5794-2-1-1 me numer të brendshëm : GRA618-25-013-211 dhe me titull Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve** Sa i përketë këtij aktiviteti të prokurimit ne kemi shkarkuar dosjen e tenderit dhe pas analizimit të kriterëve vlersojmë që AK-ja ka vendos kriterë diskriminues dhe favorizues për një **OE të caktuar**. Në vijim ju'a pasqyrojmë kriteret diskriminues dhe favorizues.

Në dosje të tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

9.1 & 9.2

4.Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt - Inxhinier i diplomuar te elektroteknikës minimum një (1). - Inxhinier apo master i diplomuar për menaxhimin të emergjencave minimum një (1). - Auto mekanik minimum katër (4). - Auto elektrikistë-minimum dy (2). - Autongjyroses-minimum një (1).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

4. Listën e stafit të punësuarve. Për inxhinierat diplomë e fakultetit përkatëse, kontratë ose parakontratat e punës me punëdhënësin. Për automekanik, elektrikistë dhe autongjyroses diplomë ose certifikatë e kualifikimit shkollor, kontratë ose parakontratat e punës me punëdhënësit.

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve dhe konsiderojmë që janë kriterë favorizues dhe diskriminues.

Inxhinieri apo master i diplomuar për menaxhimin e emergjencave konsiderojmë që është i panevojshëm pasi ky person nuk përkon fare me aktivitetin e prokurimit. Personi në fjalë nuk mund të bëjë rregullim të veturave dhe as që i përshtatet natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit. **Këtu nuk kemi të bëjmë fare me emergjencë e as bartje të pacienteve (sëmurëve) e as me shërbimet emergjente apo me zjarrfikës por me bartjen e veturave dhe rregullimin e tyre.**

Ky kriter është diskriminues dhe favorizues andaj kërkojmë të largohet si kriter

Duke u bazuar në aktivitetin e kaluar për servisim dhe mirëmbajtje të veturave ka pasur shumë më pak kriterë por pas nënshkrimit të kontratës me OE të caktuar vërehet hapur lidhja e AK-se me OE i cili i ka vendos kriteret e tij në këtë aktivitet të prokurimit.

2.Ne kuader të objektit operatorët ekonomik duhet të posedojn pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik; - Vinqa hidraulik për ngritjen e automjeteve 4200 kg-minimum (4) vinqa; - Pajisje për demontimin riparimin dhe vullkanizimin e gomave minimum (1) cope; - Pajisje speciale (kompjuterike) për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve minimum (2) cope; - Pajisje speciale për mbushje të klimave 1234 YF minimum (1) cope; - Pajisje speciale për mbushje të klimave 134A minimum (1) cope; - Pajisje për regllazh-centrim të trapit minimum (1) cope; - Pajisje për hekurosjen e karoseris-llamarines të automjetit, minimum (1) cope; - Pajisje për shtellimin e dritave minimum (1) cope; - Aparat për saldime minimum (1) cope; - Pajisje për pastrimin e sistemit të ujërave të automjeteve, minimum (1) cope; - Automjet për bartjen e automjeteve në rast defekti në rrugë me peshe bartëse min 4 tonë minimum (1) cope.

Pastaj AK-ja ka vendos si kriter pajisje për pastrimin e sistemit të ujërave të automjeteve ndësa në listën e çmimeve nuk figuron askund ky pozicion pra **pastrimi i sistemit të ujërave** andaj ky kriter apo kjo pajisje është vendosur nga AK-ja dhe dyshojmë me rekomandim të OE të caktuar vetëm sa për sy e faqe i cili nuk vjen në shprehje gjatë implementimit të kontratës.Konsiderojmë që ky është kriter favorizues i cili e favorizon vetëm një OE andaj kërkojmë të largohen këto kriterë.

Gjithashtu edhe paisja aparat për saldim njësoj është vendos te kriteret e dosjes së tenderit vetëm si kriter i cili nuk vie në shprehje gjatë implementimit të kontratës pasi që te lista e cmimeve askund nuk kemi ndonjë pozicion i cili lidhet me **SALDIM**. Edhe ky është kriter favorizues për një OE të caktuar.

Si kriter diskrimunes konsiderojm qe AK-ja ka vendos edhe Automjetin për bartje ne rast defekti ne rrugë me peshë bartëse min 4 tonë.E vlersojm si kriter diskrimunes pasi që asnjë nga veturat ne listen e cmimeve nuk e arrijn peshen 4 tonë.

Provë veturat në listen e cmimeve:

Hyundai IX55 Dizel 2959 God.2010	Skoda Oktavia Benz 1390 God.2010	WV Polo Dizel 1199 God.2011	Skoda Fabia Benz 1198 God.2010	Toyota Runner Dizel 2982 God.1999	Hyundai i30 Benz 1396 God.2009	KIA Ceed Benz 1396 God.2013
KIA Ceed Benz 1396 God.2013	WV Caddy Dizel 1896 God.2004 God.2011	Hyundai i20 Benz 1248 God.2009	Peugeot Expert Dizel 1997 God.2014	Hyundai Accent Dizel 1582 God.2012		
Peugeot 206 Benz 1587 God.2009	Toyota Bus Dozel 3661 God.2001	Iveco kombi Dizel 2998 God.2011	Toyota Prado Dizel 2982 God.2004	Mercedes Sprinter Dizel 2143 God.2017		
Peugeot 407 Dizel 1997 God.2010	Renault talisman Dizel 1997cm3 God.2020.	Dacia sandero Benz 999cm3 God.2020.	Kamionet DFSK Benz 1493cm3 God.2017.	Suzuki EY SX4 Benz 1586 God.2012	Peugeot 308 Dizel 1499cm3 God.2020.	

Andaj ky kriter është diskrimunes dhe favorizes duke e kufizuar peshen bartëse.

E kundërshtojm Refuzimin e Keundershtimit te AK-se pasi që ka bere nje vlersim te gabuar te pretendimeve tona ankimore. Vetura te cilalat jane ne listen e cmimeve nuk kan peshe bartese 4 tone asnjera prej tyre

Kërkojm nga OSHP-ja që ta aprovoj Ankesen si të bazuar dhe që AK-ja ti korigjoj kriteret e dosjes së tenderit,

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*